

# Kujdestari MENA



Kemi konsideruar që ti je MENA, domethënë një i mitur i huaj i pashoqëruar.



## Çfarë do të thotë «MENA»?

Do të thotë që:

- Je më pak se **18 vjeç**
- Nuk ke **kombësi belge**
- Prindërit e tu nuk janë me ty në Belgjikë
- Ti **nuk ke një leje-qëndrimi të vlefshme** për të qëndruar në

Në Belgjikë, të miturit e huaj të pashoqëruar kanë të drejtë për **një kujdestar**.

1



## Por... çfarë roli ka një kujdestar?

Kujdestari është një person që do të caktojme për të të shoqëruar dhe ndihmuar në jetën tënde në Belgjikë.

Ai është përfaqësuesi yt ligjor: kjo do të thotë se do të të ndihmojë në të gjitha procedurat për të jetuar në Belgjikë. Për shembull, nëse ti paraqet një kërkesë për azil ose një kërkesë për të qëndruar e jetuar në Belgjikë, ai do të të mbështesë dhe ndihmojë gjatë gjithë procedurës.

Por kujdestari bën gjithashtu gjëra të tjera. Ja disa shembuj:

- Ai vjen shpesh për të të takuar
- Ai të shpjegon vendimet e marra nga autoritetet në lidhje me ty

2

- Ai të gjen një avokat pa pagesë; Ai kontrollon që ti të ndjehesh mirë në banesën tënde dhe të ndihmon, nëse është e nevojshme, të gjesh një banesë më të përshtatshme
- Ai të regjistron në shkollë dhe kontrollon që gjithçka në shkollë shkon mirë
- Nëse ke probleme shëndetësore, ai kontrollon që të kesh të gjithë kujdesin e nevojshëm; Ai administron, në bashkëpunim me ty, paratë e tua; Kur nuk je mirë, ai dëgjon problemet e tua; Ai respekton opinionin dhe besimin tënd
- Ai flet me ty për të ardhmen tënde
- Nëse dëshiron ai do të të ndihmojë të kërkohsh prindërit e tu

Nëse ke pyetje mbi detyrat e kujdestarit tënd, mund të flasësh me të.

3



## Deri kur do të kesh një kujdestar?

Kujdestari do të të shoqërojë derisa të mbushësh 18 vjeç. Në moshën 18 vjeçare, ti bëhesh i pavarur.

Çfarë do të thotë kjo?

Do të thotë se duhet të kujdesesh vetë për veten tënde. Kujdestari nuk do të mund të marrë më vendime për ty.

**Por mos u shqetëso, kujdestari do të të ndihmojë të përgatitesh për momentin kur mbush 18 vjeç:** ai do të të këshillojë dhe shpjegojë atë që duhet të dish.

Sidoqoftë, është e mundur që puna e kujdestarit të ndërpritet përpara se të mbushësh 18 vjeç: nëse prindërit e tu mbërrijnë në Belgjikë ose nëse largohesh nga Belgjika. Në raste të tilla, do të të dërgojmë një letër për të të thënë se nuk ke më kujdestar. Kujdestari do të flasë me ty për këtë.



## Çfarë ndodh nëse ke një problem me kujdestarin tënd?

Kujdestari duhet të të dëgjojë dhe të jetë i disponueshëm për ty. Përpiqu të flasësh me të për atë që nuk të pëlqen.

### Kjo nuk funksionon?

- Na kontakto, mund të përpiqemi të zgjidhim problemin.
- Gjithashtu mund të paraqitesh përpara Gjyqtarit të paqit. Ky gjyqtar ka kompetencë të rregullojë problemet ndërmjet kujdestarit tënd dhe teje. Mund të na kërkosh më shumë informacion ose të pyesësh **asistentin social** për qendrën tënde të pritjes.



## Si mund të na kontaktosh?

Mund të na kontaktosh gjithmonë **në çdo orë dhe çdo ditë të javës** në këtë numër telefoni:

☎ **078/15.43.24**

Gjithashtu mund të dërgosh një **e-mail në adresën:**

✉ **tutelles@just.fgov.be**

Nëse ke nevojë për ndihmë për të na kontaktuar, mund t'ia kërkosh këtë **asistentit tënd social** në qendrën tënde të pritjes ose **avokatit** tënd.

